601. Arkivi i Autoritetit, Fondi Instituti, kutia 24, dosje "Mbi disa probleme që lidhen me zbatimin e rregullores së evidencës agjenturalo-operative dhe roli i saj në luftën kundër kriminalitetit", me një volum, dosja daton në vitin 1975, me 15 (pesëmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit "Sekret".
602. Arkivi i Autoritetit, Fondi Instituti, kutia 24, dosje "Tema nr. 57- Stili dhe metoda e punës së punëtorit operativ të organeve të sigurimit të shtetit", me një volum, dosja daton në vitin 1975, me 11 (njëmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit "Sekret".
603. Arkivi i Autoritetit, Fondi Instituti, kutia 24, dosje "Tema nr. 55- Organizatat kundërrevolucionare jashtë shtetit, lufta e tyre kundër RPSH dhe detyrat e organeve të sigurimit të shtetit", me një volum, dosja daton në vitin 1972, me 12 (dymbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit "Sekret".
604. Arkivi i Autoritetit, Fondi Instituti, kutia 24, dosje "Tema nr. 2- Zbatimi i vijës së masave në punën agjenturalo-operative", me një volum, dosja daton në vitin 1972, me 16 (gjashtëmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit "Sekret".
605. Arkivi i Autoritetit, Fondi Instituti, kutia 24, dosje "Tema nr. 54- Organizimi i punës agjenturalo-operative në drejtim të përfaqësive diplomatike dhe tregtare të shteteve armiq të akredituar në Republikën Popullore të Shqipërisë, me një volum, dosja daton në vitin 1973, me 37 (tridhjetë e shtatë) fletë. Niveli i klasifikimit "Sekret".
606. Arkivi i Autoritetit, Fondi Instituti, kutia 24, dosje "Tema nr. 41- Organizimi i punës agjenturalo-operative kundër veprimtarisë armiqësore në industri, gjeologji e miniera", me një volum, dosja daton në vitin 1973, me 29 (njëzet e nëntë) fletë. Niveli i klasifikimit "Sekret".
607. Arkivi i Autoritetit, Fondi Instituti, kutia 24, dosje "Tema nr. 37- Veçoritë e punës së organeve të sigurimit të shtetit në drejtim të ish klerikëve me përbërje armiqësore në kushtet e sotme", me një volum, dosja daton në vitin 1973, me 12 (dymbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit "Sekret".
608. Arkivi i Autoritetit, Fondi Instituti, kutia 24, dosje "Tema nr. 36- Veçoritë e organizimit të punës agjenturalo-operative në repartet e riedukimit dhe në burgje", me një volum, dosja daton në vitin 1973, me 16 (gjashtëmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit "Sekret".
609. Arkivi i Autoritetit, Fondi Instituti, kutia 24, dosje "Tema nr. 33- Veçoritë e organizimit të punës agjenturalo-operative në drejtim të elementit antiparti", me një volum, dosja daton në vitin 1973, me 23 (njëzet e tre) fletë. Niveli i klasifikimit "Sekret".
610. Arkivi i Autoritetit, Fondi Instituti, kutia 24, dosje "Tema nr. 29- Masat parandaluese për shpëtimin e njeriut tonë nga influenca e veprimtarisë të armikut të klasës, detyrë kryesore e organeve të punëve të brendshme", me një volum, dosja daton në vitin 1972, me 21 (njëzet e një) fletë. Niveli i klasifikimit "Sekret".
611. Arkivi i Autoritetit, Fondi Instituti, kutia 24, dosje "Tema nr. 10- Vërtetimi biografik", me një volum, dosja daton në vitin 1972, me 25 (njëzet e pesë) fletë. Niveli i klasifikimit "Sekret".
612. Arkivi i Autoritetit, Fondi Instituti, kutia 24, dosje "Tema nr. 8- Vërtetimi i takusave të objekteve tëurvejimit dhe fiksimit të adresave", me një volum, dosja daton në vitin 1972, me 27 (njëzet e shtatë) fletë. Niveli i klasifikimit "Sekret".
613. Arkivi i Autoritetit, Fondi Instituti, kutia 24, dosje "Tema nr. 7- Figura e përshkruar në përdorim tëurvejimit (temë mediko-mësimore)", me një volum, dosja daton në vitin 1973, me 24 (njëzet e katër) fletë. Niveli i klasifikimit "Sekret".
614. Arkivi i Autoritetit, Fondi Instituti, kutia 24, dosje "Tema nr. 6- Mbi maskimin e sektorit tëurvejimit", me një volum, dosja daton në vitin 1972, me 21 (njëzet e një) fletë. Niveli i klasifikimit "Sekret".
615. Arkivi i Autoritetit, Fondi Instituti, kutia 24, dosje "Tema nr. 5- Mbi marrjen në njohje të objektit tëurvejimit", me një volum, dosja daton në vitin 1972, me 16 (gjashtëmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit "Sekret".

616. Arkivi i Autoritetit, Fondi Instituti, kutia 24, dosje "Tema nr. 4- Rregullat për marrjen e objekteve në survejim", me një volum, dosja daton në vitin 1972, me 21 (njëzet e një) fletë. Niveli i klasifikimit "Sekret".
617. Arkivi i Autoritetit, Fondi Instituti, kutia 24, dosje "Tema nr. 3- Principet kryesore të punës në survejim", me një volum, dosja daton në vitin 1972, me 25 (njëzet e pesë) fletë. Niveli i klasifikimit "Sekret".
618. Arkivi i Autoritetit, Fondi Instituti, kutia 24, dosje "Tema 15 - Operacioni", me një volum, dosja daton në vitin 1977, me 20 (njëzet) fletë. Niveli i klasifikimit "Sekret".
619. Arkivi i Autoritetit, Fondi Instituti, kutia 24, dosje "Tema nr. 15- Survejimi në drejtim të përfaqësive diplomatike e tregtare të vendeve kapitalisto-revizioniste akredituar në RPSH", me një volum, dosja daton në vitin 1973, me 18 (tetëmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit "Sekret".
620. Arkivi i Autoritetit, Fondi Instituti, kutia 24, dosje "Tema nr. 4- Informacioni, rëndësia e tij dhe detyrat tona", me një volum, dosja daton në vitin 1973, me 11 (njëmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit "Sekret".
621. Arkivi i Autoritetit, Fondi Instituti, kutia 24, dosje "Tema- Mbi principet e punës agjenturalo-operative të organeve të sigurimit të shtetit në përputhje me strukturën e re", me një volum, dosja daton në vitin 1968, me 25 (njëzet e pesë) fletë. Niveli i klasifikimit "Tepër sekret".
622. Arkivi i Autoritetit, Fondi Instituti, kutia 24, dosje "Tema nr. 35- Kërkimi dhe zbulimi i autorëve të dokumenteve anonime", me një volum, dosja daton në vitin 1968, me 50 (pesëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit "Tepër sekret".
623. Arkivi i Autoritetit, Fondi Instituti, kutia 24, dosje "Tema- Mbi përsosjen e mëtejshme të metodës së analizave të punës në organet dhe repartet e Ministrisë së Punëve të Brendshme", me një volum, dosja daton në vitin 1972, me 26 (njëzet e gjashtë) fletë. Niveli i klasifikimit "Sekret".
624. Arkivi i Autoritetit, Fondi Instituti, kutia 24, dosje "Tema nr. 34- Veçoritë e punës agjenturalo-operative për mbrojtjen e inteligjencës dhe rinisë", me një volum, dosja daton në vitin 1972, me 16 (gjashtëmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit "Sekret".
625. Arkivi i Autoritetit, Fondi Instituti, kutia 24, dosje "Mbi gërshetimin e punës agjenturalo-operative me vijën e masave në shërbimet e sigurimit të shtetit", me një volum, dosja daton në vitin 1968, me 44 (dyzet e katër) fletë. Niveli i klasifikimit "Sekret".
626. Arkivi i Autoritetit, Fondi Instituti, kutia 24, dosje "Tema nr. 14-Survejimi i objektit me maqinë operative", me një volum, dosja daton në vitin 1973, me 13 (trembëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit "Sekret".
627. Arkivi i Autoritetit, Fondi Instituti, kutia 24, dosje "Tema nr. 6- Survejimi i objekteve në plazh", me një volum, dosja daton në vitin 1974, me 13 (trembëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit "Sekret".
628. Arkivi i Autoritetit, Fondi Instituti, kutia 24, dosje "Tema - Fotografimi sekret në procesin e survejimit të jashtëm", me një volum, dosja daton në vitin 1974, me 21 (njëzet e një) fletë. Niveli i klasifikimit "Sekret".
629. Arkivi i Autoritetit, Fondi Instituti, kutia 24, dosje "Tema nr. 21- Roli dhe funksionet kryesore të organeve të punëve të brendshme në sistemin e diktaturës së proletariatit", me një volum, dosja daton në vitin 1975, me 19 (nëntëmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit "Sekret".
630. Arkivi i Autoritetit, Fondi Instituti, kutia 24, dosje "Tema nr. 18- Kontingjentet e mundshme armiqësore", me një volum, dosja daton në vitin 1975, me 25 (njëzet e pesë) fletë. Niveli i klasifikimit "Sekret".
631. Arkivi i Autoritetit, Fondi Instituti, kutia 24, dosje "Tema nr. 9- Organizimi i lidhjeve me agjunkturën", me një volum, dosja daton në vitin 1975, me 34 (tridhjetë e katër) fletë. Niveli i klasifikimit "Sekret".
632. Arkivi i Autoritetit, Fondi Instituti, kutia 24, dosje "Tema nr. 40- Organizimi i punës agjenturalo-operative për mbrojtjen e ekonomisë socialiste nga veprimtaria armiqësore keqbërëse", me një volum, dosja daton në vitin 1975, me 17 (shtatëmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit "Sekret".
633. Arkivi i Autoritetit, Fondi Instituti, kutia 24, dosje "Tema nr. 43- Veçoritë e organizimit të punës agjenturalo-operative në drejtim të bujqësisë", me një volum, dosja daton në vitin 1978, me 12 (dymbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit "Sekret".
634. Arkivi i Autoritetit, Fondi Instituti, kutia 24, dosje "Tema nr. 20- Sigurimi i përpunimit agjencuror me agjunkturë", me një volum, dosja daton në vitin 1978, me 15 (pesëmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit "Sekret".
635. Arkivi i Autoritetit, Fondi Instituti, kutia 24, dosje "Tema nr. 50-Veçoritë e organizimit të punës agjenturalo-operative në shkollat e lira ushtarake", me një volum, dosja daton në vitin 1977, me 11 (njëmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit "Sekret".
636. Arkivi i Autoritetit, Fondi Instituti, kutia 24, dosje "Tema nr. 28- Implikimet në procesin hetimor", me një volum, dosja daton në vitin 1977, me 17 (shtatëmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit "Sekret".

637. Arkivi i Autoritetit, Fondi Instituti, kutia 24, dosje "Tema nr. 27- Ruajtja e sekretit gjatë procesit hetimor, domosdoshmëri për të siguruar hetim zbulues e objektit dhe efektivitetin e luftës kundër armiqve e keqbërësve", me një volum, dosja daton në vitin 1977, me 29 (njëzet e nëntë) fletë. Niveli i klasifikimit "Sekret".
638. Arkivi i Autoritetit, Fondi Instituti, kutia 24, dosje "Tema nr. 32- Tendencat dhe aktet e terrorit", me një volum, dosja daton në vitin 1977, me 12 (dymbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit "Sekret".
639. Arkivi i Autoritetit, Fondi Instituti, kutia 24, dosje "Tema nr. 16- Parime të përgjithshme të hetuesisë", me një volum, dosja daton në vitin 1977, me 19 (nëntëmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit "Sekret".
640. Arkivi i Autoritetit, Fondi Instituti, kutia 25, dosje "Tema: Metodatat eurvejimit", me një volum, dosja daton në vitin 1972, me 19 (nëntëmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit "Sekret".
641. Arkivi i Autoritetit, Fondi Instituti, kutia 25, dosje "Dërgohet përgjithësimi mbi zbulimin e goditjen e objektit përpunimit F.T", me 1 volum, në total me 8 (tetë) fletë dhe një kopje, dosja daton në vitin 1983. Niveli i klasifikimit "Sekret".
642. Arkivi i Autoritetit, Fondi Instituti, kutia 25, dosje "Tema 9: Lufta për parandalimin e krimeve dhe shpëtimin e njerëzve që janë viktimë e veprimtarisë armiqësore e keqbërëse", me 1 volum, në total me 30 (tridhjetë) fletë, dosja daton në vitin 1982. Niveli i klasifikimit "Sekret".
643. Arkivi i Autoritetit, Fondi Instituti, kutia 25, dosje "Mbi veprimtarinë armiqësore të zbulimeve revizioniste kundër vendit tonë nëpërmjet përfaqësive tregtare", me një volum, dosja daton në vitin 1976, me 13 (trembëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit "Sekret".
644. Arkivi i Autoritetit, Fondi Instituti, kutia 25, dosje "Mbi zbulimin e goditjen e një rezidenture në shërbim të zbulimit jugosllav në kooperativën bujqësore të Zerqanit në rrethin e Dibrës", një volum, dosja daton në vitin 1981, me 18 (tetëmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit "Sekret".
645. Arkivi i Autoritetit, Fondi Instituti, kutia 25, dosje "Përgjithësim: mbi disa aspekte të veprimtarisë armiqësore të zbulimeve revizioniste nën dritën e procesit kundër disa agjentëve të zbulimit polak", me një volum, dosja daton në vitin 1969, me 22 (njëzet e dy) fletë. Niveli i klasifikimit "Tepër sekret".
646. Arkivi i Autoritetit, Fondi Instituti, kutia 25, dosje "Përgjithësim: mbi zbulimin e goditjen e rezidenturës "Rengati" të zbulimit hungarez që drejtohej nga ambasada në Tiranë", me një volum, dosja daton në vitin 1981, me 18 (tetëmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit "Sekret".
647. Arkivi i Autoritetit, Fondi Instituti, kutia 25, dosje "Përgjithësim: mbi zbulimin e goditjen e rezidenturës "Kumtesë: Mbi veprimtarinë e zbulimit polak në qytetin e Korçës", me një volum, dosja daton në vitin 1970, me 10 (dhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit "Tepër sekret".
648. Arkivi i Autoritetit, Fondi Instituti, kutia 25, dosje "Mbi goditjen e agjendës së zbulimit sovjetik N.P.", me një volum, dosja daton në vitin 1976, me 9 (nëntë) fletë. Niveli i klasifikimit "Sekret".
649. Arkivi i Autoritetit, Fondi Instituti, kutia 25, dosje "Mbi disa aspekte të veprimtarisë armiqësore të zbulimeve revizioniste nën dritën e procesit të një grupi agjentësh të zbulimit sovjetik dhe detyrat tona", me një volum, dosja daton në vitin 1965, me 15 (pesëmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit "Tepër sekret".
650. Arkivi i Autoritetit, Fondi Instituti, kutia 25, dosje "Përgjithësim mbi veprimtarinë armiqësore të zbulimit Sovjetik kundër Republikës së Shqipërisë", me një volum, dosja daton në vitin 1976, me 8 (tetë) fletë. Niveli i klasifikimit "Sekret".
651. Arkivi i Autoritetit, Fondi Instituti, kutia 25, dosje "Mbi veprimtarinë armiqësore të përfaqësive diplomatike e tregtare të vendeve kapitalisto-revizioniste në drejtim të fuqisë mbrojtëse të vendit tonë gjatë viteve 1975-1977", me një volum, dosja daton në vitin 1977, me 7 (shtatë) fletë. Niveli i klasifikimit "Sekret".
652. Arkivi i Autoritetit, Fondi Instituti, kutia 25, dosje "Mbi veprimtarinë armiqësore të përfaqësive diplomatike e tregtare të vendeve kapitalisto-revizioniste në kushtet aktuale", me një volum, dosja daton në vitin 1976, me 23 (njëzet e tre) fletë. Niveli i klasifikimit "Sekret".
653. Arkivi i Autoritetit, Fondi Instituti, kutia 25, dosje "Mbi disa të meta e dobësi në organizimin e punës agjenciale-operative në drejtim të vizitorëve të huaj dhe detyrat që dalin në këtë fushë", me një volum, dosja daton në vitin 1978, me 10 (dhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit "Sekret".
654. Arkivi i Autoritetit, Fondi Instituti, kutia 25, dosje "Mbi disa të meta e dobësi në drejtim të kontrollit të të huajve", me një volum, dosja daton në vitin 1974, me 8 (tetë) fletë. Niveli i klasifikimit "Sekret".
655. Arkivi i Autoritetit, Fondi Instituti, kutia 25, dosje "Përgjithësim: mbi zbulimin e veprimtarisë armiqësore të organizatës kundërrevolucionare "Bashkimi i Kombit", me një volum, dosja daton në vitin 1986, me 35 (tridhjetë e pesë) fletë. Niveli i klasifikimit "Sekret".

656. Arkivi i Autoritetit, Fondi Instituti, kutia 25, dosje "Përgjithësim: mbi veprimtarinë e zbulimit jugosllav nëpërmjet rezidenturës Aparati", me një volum, dosja daton në vitin 1973, me 34 (tridhjetë e katër) fletë. Niveli i klasifikimit "Sekret".
657. Arkivi i Autoritetit, Fondi Instituti, kutia 25, dosje "Mbi zbulimin e rezidenturës së zbulimit jugosllav 'Aparati' goditur nga Drejtoria e Parë e Punëve të Brendshme Tiranë, me një volum, dosja daton në vitin 1974, me 13 (trembëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit "Sekret".
658. Arkivi i Autoritetit, Fondi Instituti, kutia 25, dosje "Mbi disa veçori të veprimtarisë armiqësore të zbulimit jugosllav kundër vendit tonë në periudhën 1973-1977", me një volum, dosja daton në vitin 1978, me 32 (tridhjetë e dy) fletë. Niveli i klasifikimit "Sekret".
659. Arkivi i Autoritetit, Fondi Instituti, kutia 25, dosje "Përgjithësim: mbi realizimin e procesit 'Korbi', me një volum, dosja daton në vitin 1972, me 19 (nëntëmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit "Sekret".
660. Arkivi i Autoritetit, Fondi Instituti, kutia 25, dosje "Dërgohet përgjithësimi i procesit 'Bomba', me një volum, dosja daton në vitin 1986, me 35 (tridhjetë e pesë) fletë. Niveli i klasifikimit "Sekret".
661. Arkivi i Autoritetit, Fondi Instituti, kutia 25, dosje "Përgjithësim: mbi kryerjen e një veprimi me T.O në drejtim të objektit 'Tradhëtari', me një volum, dosja daton në vitin 1975, me 3 (tre) fletë. Niveli i klasifikimit "Sekret".
662. Arkivi i Autoritetit, Fondi Instituti, kutia 25, dosje "Përgjithësim: mbi përpunimin e ruajtjes së sekretit së bashkëpunimit të agjunkturës me O.S.Sh.", me një volum, dosja daton në vitin 1969, me 4 (katër) fletë. Niveli i klasifikimit "Tepër sekret".
663. Arkivi i Autoritetit, Fondi Instituti, kutia 25, dosje "Relacion mbi procesin e D.K. e shokë për vrasjen misterioze të M.Gj. nga katundi Qelez i Pukës ish agjent i Organeve të Sigurimit të Shtetit", me një volum, dosja daton në vitin 1959, me 6 (gjashtë) fletë. Niveli i klasifikimit "Tepër sekret".
664. Arkivi i Autoritetit, Fondi Instituti, kutia 25, dosje "Disa konkluzione dhe detyra për organizimin e punës agjencurore operative në drejtim të diversantëve dhe bazave lidhjeve të dyve", me një volum, dosja daton në vitin 1978, me 17 (shtatëmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit "Sekret".
665. Arkivi i Autoritetit, Fondi Instituti, kutia 25, dosje "Përgjithësim: mbi veprimtarinë e zbulimeve të huaja kundër qytetarëve tanë që kanë dalë jashtë shtetit", me një volum, dosja daton në vitin 1974, me 13 (trembëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit "Sekret".
666. Arkivi i Autoritetit, Fondi Instituti, kutia 25, dosje "Të riadhesuarit kanali kryesor ilegal i penetrimit të agjunkturës së zbulimeve të huaja armike në Republikën Popullore të Shqipërisë", me një volum, dosja daton në vitin 1963, me 19 (nëntëmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit "Tepër sekret".
667. Arkivi i Autoritetit, Fondi Instituti, kutia 25, dosje "Përgjithësim: mbi punën në drejtim të tregtarëve e specialistëve dhe masat që duhen të merren", me një volum, dosja daton në vitin 1970, me 19 (nëntëmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit "Tepër sekret".
668. Arkivi i Autoritetit, Fondi Instituti, kutia 25, dosje "Analizë mbi veprimtarinë armiqësore të zhvilluar nga zbulimet e huaja nëpërmjet kanaleve legale në rrethin e Lushnjës (mbajtur në 7 maj 1973)", me një volum, dosja daton në vitin 1973, me 11 (njëmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit "Sekret".
669. Arkivi i Autoritetit, Fondi Instituti, kutia 25, dosje "Mbi disa të dhëna të marra kohët e fundit që flasin për veprimtari të mprehtë të zbulimeve të huaja kundër Republikës Popullore të Shqipërisë", me një volum, dosja daton në vitin 1974, me 13 (trembëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit "Sekret".
670. Arkivi i Autoritetit, Fondi Instituti, kutia 25, dosje "Përgjithësim: Drejtorisë së Parë të Sigurimit të Shtetit, me një volum, dosja daton në vitin 1976, me 13 (trembëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit "Sekret".
671. Arkivi i Autoritetit, Fondi Instituti, kutia 25, dosje "Mbi veçoritë dhe format e metodat armiqësore të zbulimit amerikan kundër vendit tonë dhe detyrat e Organeve të Sigurimit të Shtetit, me një volum, dosja daton në vitin 1978, me 28 (njëzet e tetë) fletë. Niveli i klasifikimit "Sekret".
672. Arkivi i Autoritetit, Fondi Instituti, kutia 25, dosje "Përgjithësim: mbi përpunimin e Xh.Z. si agjent i zbulimit Amerikan", me një volum, dosja daton në vitin 1980, me 12 (dymbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit "Sekret".
673. Arkivi i Autoritetit, Fondi Instituti, kutia 25, dosje "Mbi veçoritë dhe format e metodat armiqësore të zbulimit amerikan kundër vendit tonë dhe detyrat e organeve të sigurimit të shtetit", me një volum, dosja daton në vitin 1978, me 22 (njëzet e dy) fletë. Niveli i klasifikimit "Sekret".
674. Arkivi i Autoritetit, Fondi Instituti, kutia 25, dosje "Dërgohet një përgjithësim mbi goditjen e dy agjentëve të zbulimit jugosllav në rrethin e Beratit", me një volum, dosja daton në vitin 1980, me 12 (dymbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit "Sekret".

675. Arkivi i Autoritetit, Fondi Instituti, kutia 25, dosje "Relacion: Mbi grupin e Bregut të Bunës të rrethit të Shkodrës", me një volum, dosja daton në vitin 1961, me 4 (katër) fletë. Niveli i klasifikimit "Tepër sekret".
676. Arkivi i Autoritetit, Fondi Instituti, kutia 25, dosje "Përgjithësim: mbi veprimtarinë armiqësore në zonën e Fushë Alies dhe Shumpenzës, synimi i armikut kundër vendit tonë, format e punës së tij dhe zbulimit të kësaj veprimtarie", me një volum, dosja daton në vitin 1977, me 20 (njëzet) fletë. Niveli i klasifikimit "Tepër sekret".
677. Arkivi i Autoritetit, Fondi Instituti, kutia 25, dosje "Përgjithësim: zbulimin e veprimtarisë armiqësore të një rezidenture në shërbim të zbulimit jugosllav në zonën e Hasit", me një volum, dosja daton në vitin 1987, me 21 (njëzet e një) fletë. Niveli i klasifikimit "Sekret".
678. Arkivi i Autoritetit, Fondi Instituti, kutia 25, dosje "Përgjithësim: mbi format e metodat që përdorin zbuluesit e huaj që punojnë në përfaqësitë diplomatike tregtare të vendeve kapitalisto-revizioniste për t'iu shkëputur survejimit", me një volum, dosja daton në vitin 1976, me 23 (njëzet e tre) fletë. Niveli i klasifikimit "Sekret".
679. Arkivi i Autoritetit, Fondi Instituti, kutia 25, dosje "Përgjithësim: Mbi përpunimin dhe realizimin e objektit 2A të P.N, agjent i zbulimit amerikan", me një volum, dosja daton në vitin 1977, me 7 (shtatë) fletë. Niveli i klasifikimit "Sekret".
680. Arkivi i Autoritetit, Fondi Instituti, kutia 25, dosje "Përgjithësim: mbi ndjekjen, përpunimin dhe deshifrimin si agjent të zbulimit amerikan dhe francez të riadhesuarit Z.V", me një volum, dosja daton në vitin 1973, me 15 (pesëmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit "Sekret".
681. Arkivi i Autoritetit, Fondi Instituti, kutia 25, dosje "Mbi veçoritë, format dhe metodat e veprimtarisë armiqësore të zbulimit grek vitet e fundit dhe detyrat e Organeve të Sigurimit të Shtetit", me një volum, dosja daton në vitin 1978, me 36 (tridhjetë e gjashtë) fletë. Niveli i klasifikimit "Sekret".
682. Arkivi i Autoritetit, Fondi Instituti, kutia 25, dosje "Mbi disa veçori për format dhe metodat e veprimtarisë armiqësore të zbulimit sovjetik kundër Republikës Popullore të Shqipërisë dhe detyrat e organeve të Sigurimit të Shtetit", me një volum, dosja daton në vitin 1978, me 22 (njëzet e dy) fletë. Niveli i klasifikimit "Sekret".

KRYETARI I KDZH

Dr. Gentiana Sula

Vendim nr. 32, datë 13.12.2024 (i shkurtuar)

Mbështetur në nenin 44, pika 4, të ligjit nr. 45/2015 "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish - Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë", të ndryshuar, të kreut I, neni 22 pika 4, të ligjit nr. 10/2023, "Për informacionin e klasifikuar", vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 662, datë 15.11.2017 "Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar "sekret shtetëror", komisioni i deklasifikimit dhe zhvlerësimit të informacionit të klasifikuar "sekret shtetëror", në AIDSSH, i ngritur me urdhrin nr. 21, datë 06.02.2023, të Kryetarit të Autoritetit "Për krijimin e komisionit të deklasifikimit dhe zhvlerësimit të informacionit të klasifikuar "sekret shtetëror" në AIDSSH", i ndryshuar me urdhrin nr. 56, datë 23.03.2023 "Për një ndryshim në urdhrin nr. 21, datë 06.02.2023 "Për krijimin e komisionit të deklasifikimit dhe zhvlerësimit të informacionit të klasifikuar "sekret shtetëror", me Vendimin nr. 32, datë 13.12.2024 si më poshtë:

I. Deklasifikoi plotësisht informacionet e mëposhtme:

1. Fondi 2 Oficer, dosje nr. 7406, në ngarkim të N.B., me 31 (tridhjetë e një) fletë. Dosja daton në vitet 1954-1962. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret".
2. Fondi 2 Oficer, dosje nr. 4744, në ngarkim të H.S., me 29 (njëzet e nëntë) fletë. Dosja daton në vitet 1948-1953. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".
3. Fondi 2, Oficer, dega e Punëve të Brendshme Ersekë, dosje nr. 26, Buletin mbi të dhënat e rrjetit sekret informativ e burime të tjera në repartin e kufirit 310, me 24 (njëzet e katër) fletë. Dosja daton në vitin 1990. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret".
4. Fondi 2, Oficer, dosje nr. 6618, në ngarkim të H.L., me 78 (shtatëdhjetë e tetë) fletë. Dosja daton në vitet 1955-1989. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".
5. Fondi 2, Oficer, dosje nr. 9060, në ngarkim të Xh.M., me 74 (shtatëdhjetë e katër) fletë. Dosja daton në vitet

1949-1982. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

6. Fondi 2, Oficer, dosje nr. 9170, në ngarkim të A.M., me 73 (shtatëdhjetë e tre) fletë. Dosja daton në vitet 1973-1983. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

KRYETARI I KDZH

Dr. Gentiana Sula



KUJTESA DHE EDUKIMI QYTETAR

SHENJOHET VENDVARRIMI I DYSHUAR “VARRI I BOLENASIT”

Selenicë 4 nëntor 2024



Pas më shumë se 80 vjetësh në pritje, një hap i rëndësishëm u ndër-mor në fshatin Mallkeq, Selenicë. Serjan Alikaj, 60 vjeç, iu bashkua ekipit të Drejtorisë së Identifikimit dhe Rikuperimit të Personave të Zhdukur, kryetarit të Njësisë Administrative Vllahinë, z. Pëllumb Shametaj, për të vendosur tabelën shenjzuese në vendvarrimin e dyshuar të xhaxhait të tij, Rait Bajram Alikaj.

Rait Alikaj ishte 22 vjeç dhe i angazhuar me forcat e Ballit Kombëtar, gjatë luftës antifashiste në vend. Vendosja e regjimit dhe shpallja armik e këtij grupimi politik e detyroi atë të tentonte arratisjen, por ra në përleshje me forcat e ndjekjes, ndërsa i vëllai arrestohet dhe vdes në burgun e Gjirokastrës. Nga shtëpia e Serjanit, ka pesë të pushkatuar, dhe ai do të plotësojë amanetin e të atit për një varr të

denjë për Raitin. Familja kërkoi pas viteve 90 por nuk arriti ta gjente për shkak të mungesës edhe të mjeteve të kërkimit, por edhe të një lëvizjeve që iu ishte bërë eshtrave.

Një vit më parë Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, nisi hetimin administrativ ku nga dëshmitare të zonës të mbetur gjallë, por edhe nga të tjerë të cilët kishin dëgjuar dëshmitë e prindërve të tyre, mësoi se “Varri i Bolenasit” ndodhej 100 metra më tutje nga vendi ku u ekzekutua.

Në kuadër të përmbushjes së përgjegjësisë për ruajtjen e kujtesës kombëtare, AIDSSH ka përgatitur tabela për të shënjuar këto hapësira kujtesë edhe në 8 vendvarrime të tjera të dyshuara për të zhdukurit gjatë periudhës komuniste ndër-kohë që vitin e shkuar një tabelë e tillë u vendos në Shkodër.

Gjatë vitit 2024, janë realizuar hetime administrative për të identifikuar vendvarrime të tjera të dyshuara në lidhje me të vrarët në kufi dhe të zhdukurit në burgje si Burgu i Burrelit, ai i Gjirokastrës, Shkodrës, Kampi i Tepelenës dhe zona e Spaçit. Deri më tani, janë identifikuar 7 vendvarrime të dyshuara dhe 2 prej tyre janë verifikuar plotësisht.

Këto hetime përfshijnë dëshmi nga dëshmitarët dhe përpjekjet për ruajtjen e kujtesës historike. AIDSSH u bën thirrje institucioneve vendore që të mbrojnë këto vende të rrezikuara nga zhvillimet urbanistike të vrullshme, duke ruajtur kështu një pjesë të rëndësishme të historisë sonë kombëtare.

AKADEMIKËT RUMUNË VIZITOJNË AIDSSH-NË

Tiranë, 5 nëntor 2024



Një delegacion i përbërë nga profesorë dhe akademikë të Universitetit të Iaşit, Rumani zhvilloi një vizitë zyrtare në Autoritetin për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit. Delegacioni përfshinte emra të shquar si: Prof. Dr. Teodora Prelipcean (Rektore e Universitetit të Iaşit), Prof. Dr. Georgeta Condur (Zëvendës Rektore), Prof. Dr. Sorin Bocancea, Prof. Dr. Cristian Bocancea, Prof. Dr. Constantin Ilaş (Profesor në Universitetin e Iaşit), Prof. Dr. Mioara Anton (Drejtoreshë e Përgjithshme e Institutit të Historisë “Nicolae Iorga”), Prof. Dr. Sabin Drăgulin (Këshilltar i Kryetarit të Senatit Rumun) dhe Dr. Ioana Drăgulin (përfaqësuese nga Muzeu Kombëtar i Presidentit të Rumanisë, Cotroceni), si dhe Prof. Dr. Daniel Şandru, President Ekzekutiv i Institutit për Hetimin e Krimeve të Komunizmit dhe Kujtimit, Rumun.

Gjatë takimit, u diskutuan përvojat dhe praktikat e Shqipërisë në trajtimin e së kaluarës së saj dhe në procesin e dekomunistizimit. Takimi u fokusua në shkëmbimin e ideve dhe përvojave për të forcuar qasjen institucionale dhe për të promovuar një kujtesë historike të drejtë, duke reflektuar mbi hapat që duhen ndërmarrë për t’u përballur me trashëgiminë e regjimeve komuniste në të dy vendet.

INTESIFIKOHET BASHKËPUNIMI ME INSTITUTIN E HISTORISË “ALI HADRI” NË PRISHTINË

Prishtinë 5-6 nëntor 2024



Në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit mes AIDSSH-së dhe Institutit të Historisë “Ali Hadri, Prishtinë, një grup nga AIDSSH zhvilloi një vizitë pune në Prishtinë. Delegacioni i Autoritetit i kryesuar nga Anëtarët: Z. Gjergj Marku, Z. Altin Hoxha dhe Dr. Albert Nikolla, zhvilloi një takim me përfaqësues të këtij Institucioni dhe konkretisht me Prof. Dr. Teuta Shala-Peli, Drejtuese e Institutit të Historisë, z. Arbër Hadri, studiues shkencor dhe z. Arbër Kuqi jurist.

Në takim u diskutua për hartimin e projekteve të përbashkëta, të cilat do të realizohen pas rinovimit të marrëveshjes së lidhur mes dy institucioneve në vitin 2018. Palët shprehën vlerësimin për bashkëpunimin e arritur deri tani dhe në shkëmbimin e botimeve dhe pjesëmarrjen e ndërsjellë të studiuesve në aktivitetet përkatëse.



Nga përfaqësuesit e Autoritetit, u sugjerua që kërkimi i palës kosovare mund të fillojë në shqyrtimin e dosjeve të krijuara nga ish Sigurimi i Shtetit për shtetasit kosovarë të cilët kalonin kufirin për të gjetur lirinë në “Shqipërinë nanë”, por që fatkeqësisht u desh të përballeshin me përndjekjen, vëzhgimin deri dhe dënimin me burg si “agjentë të UDB” apo të dërguar të regjimit Titist.

Drejtoresha e Institutit “Ali Hadri”, pasi falenderoi për vizitën, shprehu gatishmërinë për bashkëpunimin bilateral, si dhe angazhimin e institucionit që ajo drejton, për identifikimin, dhe organizimin e aktiviteteve konkrete në fushën e kërkimit shkencor historik me qëllimin fisnik të rishikimit të historisë së gjysmës së dytë të shekullit të 20-të.

Gjatë vizitës në Prishtinë delegacioni vijoi me një takim me Universitetin e Prishtinës dhe Institutin Shqiptar të Kulturës, në të cilin të pranishmit si studiues pedagogë e studentë u njohën me botimet e Autoritetit, projekte mbi edukimin qytetar dhe kërkimin shkencor.

Pjesë e grupit të punës ishte dhe Anëtari i Autoritetit z. Albert Nikolla, i cili në cilësinë e studiuesit e kërkuesit shkencor gjeti rastin të ndajë me të pranishmit në këtë takim eksperiencën me dokumentet e trajtuara të arkivit të Autoritetit për librin e tij të fundit “Antikultura e 68-tës”. Kjo përvojë u mirëprit nga të pranishmit dhe u propozua nga këta të fundit, që të vijohet edhe përgjatë vitit 2025-së, për ta vënë në planin e punës së institucioneve jo vetëm për librin në fjalë, por edhe për libra të ngjashëm.

AMBASADORI I BE-SË: “DREJTËSIA DHE KUJTESA JANË HAPA KRITIKË PËR SHQIPËRINË”

Tiranë 5 nëntor 2024



Ambasadori i BE ne Tiranë, Z. Silvio Gonzato njihet me punën e Autoritetit të Dosjeve, organizimin e arkivës së dokumenteve të Ish-Sigurimit të Shtetit, botimet shkencore, si dhe projektin madhor të AIDSSH –së, Platformën digjitale të edukimit – “Mësojmë nga e Kaluara”.

“Përcaktimi i së vërtetës, rivendosja e transparencës dhe dëmshpërblimi i duhur i viktimave të brutalitetit komunist janë e vetmja mënyrë për të rikthyer dinjitetin e viktimave dhe për t’i hapur rrugën pajtimit. Drejtësia dhe kujtesa janë hapa kritikë për Shqipërinë drejt anëtarësimit në BE. Sot vizitova Autoritetin për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit dhe diskutova me kryetaren Gentiana Sula mbi rolin e tyre vendimtar për të hedhur dritë mbi periudhën e errët të së shkuarës komuniste. Me mbështetjen e BE-së, Shqipëria po trajton çështjen e personave të zhdukur në një përpjekje për të nderuar viktimat si dhe për të edukuar të rinjtë e saj përmes gabimeve të së shkuarës,” u shpreh Ambasadori Gonzato.

AMBASADORIN E RI TË SUEDISË NË TIRANË NJIHET ME PUNËN E AIDSSH-SË

Tiranë 6 nëntor 2024



Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit synon të promovojë mendimin kritik rreth të kaluarës sonë të errët, duke krijuar mundësi për njohje të drejtë dhe të thelluar të saj. Në këtë frymë, bashkëpunimi me Ambasadorin e Suedisë në Shqipëri mbetet thelbësor për realizimin e projekteve që synojnë rritjen e ndërgjegjësimit historik dhe edukimit të brezave të rinj.

Gjatë takimit me Ambasadorin e ri të Suedisë në Tiranë, z. Niklas Ström, u diskutua mbi avancimin e projekteve të përbashkëta, si platforma digjitale “Mësojmë nga e kaluara - me burime parësore 1944-1991.” Kjo platformë e-learning, e krijuar për mësuesit e sistemit arsimor parauniversitar, do të shërbejë si burim informacioni për periudhën e regjimit komunist në Shqipëri dhe do të kontribuojë në rritjen e njohurive historike të nxënësve.

Ky bashkëpunim i frytshëm do të vijojë në funksion të edukimit të brezave të rinj, duke u ofruar atyre qasje në histori të bazuar mbi fakte, për të nxitur reflektimin dhe vetëdijen kritike mbi të kaluarën.

PËRPARËSITË E AIDSSH-SË PËR VITIN 2025

Tiranë, 13 nëntor 2024

Viti 2025 është një vit i rëndësishëm për AIDSSH-në. Gjatë këtij viti është përgatitur një plan për forcimin e sigurisë së sistemeve kibernetike dhe mbulimin e kostove operative. Ndërkohë, investimet në platformën “Mësojmë nga e kaluara” dhe ndërtimi i varrezës monumentale janë planifikuar për vitin 2025, me shpresë që kërkesa buxhetore do të miratohet, përndryshe do të shtyhet në 2026.



AIDSSH kërkon rrisë investimet në sigurinë e sistemeve të informacionit me qëllim mbrojtjen e të dhënave të ndjeshme. Investimet do të përfshijnë strategji mbrojtëse, auditime të sigurisë dhe trajnime për stafin.

Kostot operative mbeten thelbësore në funksionimin e përditshëm të AIDSSH-së. Këto shpenzime përfshijnë mirëmbajtjen e sistemit të informacionit dhe digjitalizimin e dokumenteve historike.

Për vitin 2025, AIDSSH-ja do të fokusohet në platformën edukative “Mësojmë nga e kaluara”, e cila do të ndihmojë qytetarët të kuptojnë ngjarjet historike. Gjithashtu, ndërtimi i varrezës monumentale do të nderojë kujtesën e viktimave të regjimit komunist.

Me këto prioritete, AIDSSH-ja thekson rëndësinë e mbështetjes buxhetore për vitin 2025. Investimet në siguri dhe në funksionimin e përditshëm janë thelbësore për ruajtjen e historisë sonë.

MËSOJMË NGA E KALUARA - EDUKIMI I TË RINJVE RRETH DEMOKRACISË DHE TË DREJTAVE TË NJERIUT

Tiranë 14 nëntor - 10 dhjetor 2024



Turiil Leximit “Mësojmë nga e Kaluara” po edukon brezin e ri rreth të kaluarës historike të vendit, duke nxitur njëkohësisht reflektimin mbi demokracinë dhe të drejtat e njeriut. Nisma e përbashkët e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit (AIDSSH) Këshillit të Europës nisi në datën 14 nëntor 2024. Deri në fund të këtij viti u realizuan 5 takime në Tiranë, Durrës dhe Kavajë.

150 nxënës dhe 17 mësues nga shkollat “Eqrem Çabej” dhe “Sami Frashëri” në Tiranë, shkollat “Hamza Muça” dhe “Naim Frashëri” në Durrës, si dhe shkolla “Aleksandër Moisiu” në Kavajë, morën pjesë në këtë nismë që synon të kultivojë një kuptim kritik mbi historinë e Shqipërisë që do të shërbejë si bazë për promovimin e parimeve demokratike dhe tolerancës.



Nxënësit morën pjesë në aktivitete të ndryshme ndërgjegjësuese, duke përfshirë takime me ekspertë, shfaqje dokumentarësh mbi aspekte kyç të periudhës 1944-1991, diskutime me nxënës, mësues dhe anëtarë të komunitetit, si dhe dëshmi. Gjithashtu, ata eksploruan materiale të përgatitura nga AIDSSH në seanca leximi, duke lidhur në mënyrë efektive mësimet historike me vlerat e demokracisë.

Gjatë këtij turi janë lexuar dhe diskutuar botimet e AIDSSH-së për arsimin parauniversitar “Dielli lind në Spaç” dhe “Spaç, historia e një revolte” si dhe është shfaqur dokumentari me metrazh të shkurtër “3 ditët e lirisë në Spaç” prodhim i AIDSSH-së, me mbështetjen e KiE-s.

Kjo nismë e cila vjen në kuadër të Klubit të Librit në AIDSSH dhe të platformës “Mësojmë nga e kaluara, burime të hapura arsimore 1944-1991” forcon njohuritë mbi historinë e Shqipërisë dhe nxit mendimin kritik, duke fuqizuar brezat e rinj që të përdorin këto njohuri për të kontribuar në një të ardhme demokratike.

Vitin e ardhshëm, aktivitetet do të vijojnë me një konkurs kombëtar duke inkurajuar të rinjtë të paraqesin punime krijuese si vizatime, ese, apo video që reflektojnë mësimet dhe perspektivat e tyre.

Projekti i Këshillit të Evropës Forcimi i Edukimit për Qytetari Demokratike në Shqipëri ku është përfshirë nisma “Mësojmë nga e kaluara” financohet nga Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar.

GJURMËT E TË ZHDUKURE TË SPAÇIT, AIDSSHJ SHENJON VENDVARRIMET E DYSHUARA

Mirditë 14 nëntor 2024

Me një thirrje për Rikuperimin e Trupave të Ekzekutuarve të Regjimit Komunist dhe aksionin për mos tjetërsimin e vendeve të dyshuara si vendvarrime, grupi i punës së AIDSSH-së, drejtuar nga anëtarë Gjergj Marku, vendosi dy tabela në zonën e Shpalit, njësi administrative Orosh, Mirditë.



Tabela e parë shënon vendvarrimin e identifikuar të Shpalit, ku janë varrosur të burgosur politikë të vdekur gjatë vuajtjes së dënimit. Tabela e dytë shënon një vendvarrim të dyshuar për katër të burgosur politikë të ekzekutuar si organizatorë të Revoltës së Spaçit të vitit 1973: Skënder Daja, Pal Zefi, Dervish Bejko dhe Hajri Pashaj. Shteti komunist fshehu trupat e tyre, duke lënë familjarët pa asnjë informacion për vendndodhjen e tyre.

Fillimisht, grupi i punës i AIDSSH zhvilloi një takim në zyrën e Kryetarit të Bashkisë Mirditë, z. Albert Mëlyshi, për të diskutuar ecurinë e procesit. Të shoqëruar nga kryetari i njësisë administrative Orosh, grupi vijoi me vendosjen e tabelave.

Ky shenjëzim është kulmimi i një hetimi të thelluar 6-mujor, që synoi qartësimin e fatin e 44 të zhdukurve gjatë vuajtjes së dënimit në Burgun e Spaçit, një nismë kjo në kuadër të përkujtimit të 50-vjetorit të Revoltës së të Burgosurve si dhe është një përpjekje për të nderuar kujtimin e viktimave të komunizmit dhe për të rikthyer në dritë historinë e të zhdukurve

Raporti përfundimtar cilëson se vendi i dyshuar ndodhet afërsisht 20 metra nga vendvarrimi i njohur i Shpalit dhe është i gatshëm për kërkime të mëtejshme për eshtrat. Lënia pa asnjë evidencë nga autoritetet e kohës dëshmon për qëllimshmërinë e regjimit në fshehjen e këtyre krimeve.

Grupi i punës ka bashkëpunuar ngushtë me institucionet e tjera dhe ka mbledhur dëshmi nga familjarë dhe banorë të zonës, për të sjellë sa më shumë informacion mbi këto ngjarje të trishta të historisë.

AIDSSH po përpqet të sigurojë mbështetjen e institucioneve kyçe për të ndihmuar në rikuperimin e trupave të atyre që u ekzekutuan ose u zhdukën gjatë regjimit komunist. Kjo përpjekje e përbashkët kërkon bashkëpunim të ngushtë nga institucionet dhe organet përkatëse për të ndihmuar në kthimin e dinjitetit dhe nderimit për viktimat dhe për të qetësuar familjet e tyre.

Autoriteti falënderon institucionet e përfshira dhe mirëpret një angazhim më të madh për të bërë të mundur që plaga e pambyllur e familjeve të cilat kërkojnë qartësimin e fatit të të afërmeve të tyre të mbyllet me gjetjen e eshtrave dhe nderimin e kujtimit të tyre.

AMBASADORI BRITANIK NË SHQIPËRI, PËRSHËNDET PROGRESIN E AIDSSH-SË NË ZBARDHJEN E SË KALUARËS

Tiranë 10 dhjetor 2024



Ambasadori Britanik në Shqipëri, z. Nicholas Abbott, vizitoi Autoritetin për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (AIDSSH) dhe shprehur vlerësimin për përpjekjet e palodhshme të stafit në drejtim të zbardhjes së së kaluarës komuniste. Ai theksoi se përparimi në këtë drejtim është jetik për të ardhmen e Shqipërisë dhe në dobi të të gjithë qytetarëve shqiptarë.

“Shqipëria duhet të vazhdojë të bëjë progres në këtë fushë, për të cilën historia e së kaluarës ende mbetet një çështje e ndjeshme dhe e kontestuar. Transparenca dhe ndriçimi i së shkuarës janë thelbësore për pajtimin dhe ndërtimin e një të ardhmeje më të mirë,” u shpreh ambasadori.

Ambasadori Abbott pati mundësinë të vizitonte arkivin ku ruhen dokumentet historike dhe të njëjtit me platformën digjitale “Mësojmë nga e kaluara – burime të hapura arsimore 1944-1991”. Kjo platformë e-learning, e krijuar posaçërisht për mësuesit e sistemit arsimor parauniversitar, ofron burime autentike për periudhën e regjimit komunist në Shqipëri dhe synon të pasurojë njohuritë historike të nxënësve.

Platforma përfaqëson një hap të rëndësishëm për edukimin e brezave të rinj, duke ofruar qasje në histori të bazuar mbi fakte dhe duke nxitur reflektimin kritik mbi të kaluarën. Ky bashkëpunim i frytshëm ndërmjet AIDSSH-së dhe partnerëve do të vazhdojë në funksion të ngritjes së ndërgjegjes kombëtare dhe ndriçimit të periudhës së errët të diktaturës.

Gjatë vizitës, ambasadori diskutoi me kryetaren Gentiana Sula për rolin e rëndësishëm të Autoritetit në ndriçimin e së shkuarës dhe rëndësinë e këtij procesi për të garantuar drejtësi historike dhe edukim të shëndoshë për brezat e ardhshëm.

Z. Abbott shprehur angazhimin e Mbretërisë së Bashkuar për të mbështetur më tej nisma që ndihmojnë Shqipërinë të përballlet me të kaluarën e saj, duke nxitur pajtimin dhe forcimin e demokracisë në vend.

GJIMNAZISTËT E “PETRO NINI LUARASI” VIZITË NË AIDSSH

Tiranë 12 dhjetor 2024



Nxënësit e gjimnazit “Petro Nini Luarasi” përkujtuan Ditën e Rinisë me një vizitë në e Autoritetin për Informimin e Dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit.

Gjatë vizitës, ata patën mundësinë të shfletonin dosje që dëshmojnë për jetët e survejuara, persekutimet dhe sfidat e fshehura për dekada. Dokumentet, raportet sekrete dhe dëshmitë që studiuuan tregonin histori të guximit dhe të dhimbjes njerëzore.

Të shoqëruar me shpjegimet e duhura nga Drejtori i Arkivit, Anton Dukagjini dhe specialistet e arkivit, Gerald Vjollca, Irma Caushi Bataj, Betim Gjaci Klajvi Turka ata hynë në sallat ku ruhen dokumentet e Ish-Sigurimit dhe u njohën me tipologjitë e dokumentit. Dr. Edlir Orhani, i Drejtorisë së Komunikimit Shkencor vijoi me tej tregimin mbi procesin e studimit dhe të hulumtimit të dokumentet nga ana e studiuesve dhe punonjesve të edukimit qytetar në institucion.

Kjo vizitë ishte më shumë sesa një udhëtim në të shkuarën; ajo shërbeu si një përkujtim i fuqishëm për të mos harruar historinë dhe për të vlerësuar lirinë që gëzojmë sot.

“NË EMËR TË NJERIUT”: KUJTOHET DITA NDËRKOMBËTARE E TË DREJTAVE TË NJERIUT

Më 17 dhjetor 2024

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (AIDSSH) organizoi aktivitetin “Në emër të Njeriut”, në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut. Aktiviteti, i cili u zhvillua në ambientet e AIDSSH, kishte për qëllim të theksonte rëndësinë e ndërgjegjësimit për të drejtat e njeriut dhe pasojat e regjimeve totalitare në Shqipëri, përmes shfaqjes së tre dokumentarëve të rëndësishëm.

Gentiana Sula, Kryetare e AIDSSH, theksoi se rishqyrtimi i historisë është një hap i domosdoshëm për të ruajtur kujtesën kolektive dhe për të përballuar sfidat që ende vijojnë nga trashëgimia e regjimit totalitar,



“Lëvizja për rishqyrtimin e historisë është një akt i jashtëzakonshëm i kurajës dhe integritetit. Ky proces është një mundësi për të ripërtërirë kujtesën tonë kolektive dhe për të ndihmuar shoqërinë të kuptojë se historia nuk është vetëm e shkruar, por gjithashtu ndërtuar nga të vërtetat e fshehura.”

Ambasadori i Bashkimit Europian në Shqipëri, Z. Silvio Gonzato, i cili theksoi rëndësinë e transparencës dhe të drejtësisë në procesin e përballjes me të kaluarën komuniste tha se:

“Ky aktivitet na jep mundësinë të nderojmë publikisht ish-të përndjekurit politikë dhe familjet e tyre. Por kujtesa nuk është vetëm për ata që jetuan në ato kohë famëkeqe; ajo është gjithashtu për brezat e ardhshëm. Edhe ata duhet të kujtojnë zh-



dukjet e ndodhura gjatë regjimit komunist dhe të nderojnë viktimat e represionit dhe heshtjes. Kjo na kujton nevojën për të mbrojtur natyrën universale dhe të pandashme të të drejtave të njeriut.”

Ambasadori Gonzato theksoi gjithashtu rolin e AIDSSH dhe të partnerëve të saj në adresimin e çështjes së të zhdukurve gjatë periudhës komuniste: *Sot është gjithashtu një mundësi për të njohur punën, rolin dhe përkushtimin e atyre që po angazhohen në procesin e ndriçimit të fatit të personave të zhdukur gjatë komunizmit në Shqipëri, veçanërisht të Autoritetit të Dosjeve. Ajo çka ju bëni në ruajtjen e dokumenteve, në bërjen e tyre të aksesueshme, në nxitjen e debatit dhe në promovimin e drejtësisë është e paçmuar.”*

Në këtë aktivitet, të organizuar në bashkëpunim me Festivalin Ndërkombëtar të Filmit për të Drejtat e Njeriut, Delegacionin European në Shqipëri, ISKK, Fondacionin Kujto.al dhe ICMP, u shfaqën dokumentarët e mëposhtëm:

“*Revolta që tronditi diktaturën*” – Një dokumentar që pasqyron revoltën e të burgosurve politikë në kampin e Spaçit më 1971, përmes dëshmive dhe materialeve arkivore, I prodhuar nga Institutit i Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit, me skenar të Ergys Mërtirit dhe regji të Indrit Kasmit.

“*Muzeu Virtual i Kampeve të Maliqit*” – Një rikrijim dixhital i kampeve të punës së detyruar në Tepelenë dhe Maliq,

bazuar në dëshmitë e të mbijetuarve dhe dokumente të kohës. Bashkëpunimi i Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit dhe Fondacionit-Konrad-Adenauer, me skenar të Luljeta Lleshanakut dhe regji të Elton Baxhakut.

“*Varret pa Emër*” – Një dokumentar që hedh dritë mbi varret masive të periudhës komuniste dhe përpjekjet për identifikimin e viktimave të regjimit. Dokumentar i prodhuar nga Fondacioni Kujto, mbështetur nga Programi i granteve të vogla të ICMP, financuar nga BE dhe Ambasada e Zvicrës.

Pas shfaqjes së filmave, aktiviteti vazhdoi me diskutime dhe pyetje nga audienca, duke ofruar një mundësi për reflektim dhe bashkëbisedim mbi tematikat e trajtuara. Ky aktivitet ishte një hap i rëndësishëm në procesin e ndërgjegjësimit të shoqërisë dhe përpjekjeve për një të ardhme demokratike dhe të qëndrueshme.

EKSPOZOHEN PËR HERË TË PARË PRODUKTET E AIDSSH DEDIKUAR REVOLTËS SË SPAÇIT

Tiranë, 20 Dhjetor 2024

Foto dhe ilustrime, dëshmi dhe botime, dokumentar dhe një faqe interneti me kryefjalën “Spaç”, produkte që fuqizojnë kujtesën, u ekspozuan për herë të parë në Qendrën e Artit “Agimi” nga Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (AIDSSH), me praninë e të mbijetuarëve, familjeve të tyre, aktorë të kujtesës, partnerë etj.

AIDSSH ka prodhuar 6 produkte mediatike, tekst dhe audiovizuale në funksion të njohjes dhe edukimit, me ngjarje që lidhen me kampin-burg të Spaçit, revoltën e ish - të burgosurve politikë, dënimet e ashpra, keqtrajtimet, punën e detyruar të papaguar.





Në aktivitet u prezantua: Libri “50 vjet nga revolta në burgun e Spaçit” një përmbledhje dëshmish autentike. Faqja web Spac.al, e cila shërben si një arkiv interaktiv mbi historinë e revoltës. Libra metodike dhe edukative për nxënës të ciklit të mesëm të ulët dhe të lartë: “Dielli lind në Spaç” dhe “Spaçi, historia e një revolte”. Ekspozita me portrete dhe skica grafike, që sjellin në jetë kujtimet e ish-të dënuarve politikë dhe ngjarjen si dhe dokumentari me metrazh të shkurtër “3 ditët e lirisë në Spaç”.

Dr. Gentiana Sula, Kryetare e AIDSSH, në fjalën e saj theksoi rëndësinë e ruajtjes së kujtesës kolektive, ndriçimit të së kaluarës dhe shprehur mirënjohjen për të gjithë ata që kanë pasur guximin të përballen me padrejtësitë e regjimit dhe të rezistojnë në emër të lirisë dhe dinjitetit njerëzor.



“Fuqia e kujtesës tuaj është një pasuri e pazëvendësueshme për shoqërinë tonë. Duke ndarë përvojat dhe dëshmitë tuaja, ju keni hapur dyer për t’u përballur me traumat e së kaluarës, duke krijuar një mundësi për kurim dhe reflektim për të gjithë ne. Kjo na ndihmon jo vetëm në nderimin e atyre që humbën jetën, por gjithashtu që shoqëria jonë të mësojë nga e kaluara për të ndërtuar një të ardhme më të drejtë dhe njerëzore. Pavarësisht përpjekjeve për të shëruar plagët e historisë, rruga për të kuptuar dhe përmbushur borxhin financiar, moral dhe ligjor që Shqipëria ka ndaj jush, mbetet ende e gjatë. Pavarësisht kësaj ju keni dhënë një leksion të jashtëzakonshëm fisnikërie, faljeje dhe dashurie për jetën dhe njerëzit. Ky leksion na bën më të mirë dhe më të fortë si shoqëri. Sa më thellë e kuptojmë këtë mësim, aq me shumë do të kontribuojmë në ndërtimin e një të ardhmeje më të ndritur për të gjithë ne. Respekt dhe mirënjohje për ju!”

Më pas stafi i AIDSSH-së prezantoi produktet e reja, duke ofruar detaje mbi punën pas këtyre botimeve dhe ekspozitave.



Ish-të dënuar politikë, të cilët përjetuan kamp-in-burg të Spaçit dhe revoltën historike, ndanë kujtimet e tyre me audiencën. Në vijim, u mbajt një minutë heshtje në nderim të Gëzim Çelës dhe Ylber Merdanit, ish-të dënuar politikë që kanë ndarë dëshmitë e tyre me AIDSSH, por nuk janë më mes nesh, ku u përcoll një mesazh prekës për jetën dhe përkushtimin e tyre në shërbim të kujtesës.



Eventi u mbyll me një vizitë të ekspozitave, ku pjesëmarrësit patën mundësinë të njihen nga afër me botimet, dokumentarin dhe portretet e krijuara nga Dorian Zanaliu dhe grafikantet e Anila Zajmi-Katanollit, që pasurojnë librin për fëmijë shkruar nga shkrimtarja Rovena Rozhani, ndërtuar mbi dokumenteve arkivore dhe dëshmitë e AIDSSH.



AUTORITETI PER INFORMIMIN MBI
DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TE SHETIT

Adresa: Njësia Administrative nr. 4
Rruga e Dibrës, garnizoni "Skënderbej", Tiranë